NJOFTIM PUNËSIMI	
Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK	Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura". Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë. Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për një vend pune: **Manovrues pranë Sektorit të Transmetimit/Fushë Kuqe në Drejtorinë e Prodhimit dhe Transmetimit të Ujit**. Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës për kontrollin dhe raportimin, çdo ditë, tek Përgjegjësi i Sektorit të Transmetimit për gjendjen e linjave që ka nën kontroll. Detyrat përfshijnë gjithashtu evidentimin e çdo humbje ose problemi në linjën që mbulon ose në aksesorë (saraçineska, ajrues, shkarkues, etj.) dhe ta paraqesë atë me shkrim pranë Përgjegjësit.
Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:	• Nuk lejon të riparohen defektet jashtë kushteve teknike e të sigurimit teknik. Për çdo punim jashtë kushteve teknike duhet të njoftojë menjëherë Përgjegjësin e Sektorit të Transmetimit. • Bën evidentimin e lidhjeve dhe ndërhyrjeve të paligjshme që mund të bëhen në këto linja. • Merr pjesë në grupet e punës për ndërprerjen e lidhjeve të paligjshme të bëra në pjesën e linjës që ai mbulon. • Në raste avarie kryen manovrimet e duhura për të bërë punimet e nevojshme. • Përgjigjet për kryerjen e shërbimit të manovrimit sipas grafikut të miratuar. Është përgjegjës për çdo moszbatim të grafikut ose për ndryshimin e tij pa miratimin e Përgjegjësit të Sektorit të Transmetimit. • Marrja në dorëzim e turnit bëhet vetëm me proces-verbal të rregullt, ku pasqyrohen këto procese pune: a. Kontrolli i prurjes së ujit b. Gjendja e saraçineskave, etj. • Mban përgjegjësi, sipas shkallës së dëmit dhe rrezikshmërisë, për të gjitha veprimet e kryera në kundërshtim me Urdhrat e dhënë nga Përgjegjësi i

	Sektorit të Transmetimit, apo për mos realizimin në afat dhe me cilësi të detyrave të ngarkuara. • Bën të gjitha manovrimet e caktuara për punimin normal të linjave. • Bashkëpunon me Drejtorinë e Mirëmbajtjes dhe mbështet grupet e tyre të punës që dërgohen për zgjidhjen e problemeve teknike në linjat e transmetimit.
Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:	• Eksperienca pune të mëparshme. • Librezë e Punës • Certifikatë Familjare • Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës • Dy fotografi • Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar • Dëshmi Penaliteti • Raporti Mjekësor • Vërtetim Vendbanimi
Kushtet e punës:	• Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur. • Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.

- Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 27.10.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.